



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**  
**BASHKIA BULQIZE**

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email.bashkia.bulqize@bulqize.gov.al

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Bulqizë, më \_\_\_\_/05/2021

Per: **ERALD-G** sh.p.k, Adresa: Diber Maqellare HERBEL Zyra në katin e parë, banesa 2- katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna Maqellarë Nipti: K36306784K

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-92949-04-13-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Mbikqyrje punimesh per objektin, Rikonstruksion total i Rrjetit te furnizimit me uje te Qytetit Bulqize dhe rrjeti shperndaresi Qytetit te ri Faza II.**

Publikime të mëparshme, (nuk ka):

Buletini i Njoftimeve Publike **Nr. 58 datë 19 Prill 2021**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

oferta ekonomikisht më e favorshme

Hapja ofertave u be me: **26.04.2020 09:00**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ERALD-G sh.p.k me Nipt K36306784K

Vlera: *2 201 578( dy milion e dyqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë ) Leke pa TVSH*

2 INSTITUTI DEKLIADA – ALB me Nipt K71606006A

Vlera: *2 190 511,15 ( dy million e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje pesëmbëdhjetë ) Leke pa TVSH*

3. STUDIO SERVICES “K-SA” Me NIPT: L71305518R

Vlera: *2 190 511,23 ( dy million e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje njëzet e tre ) Leke pa TVSH*

4. NOVATECH STUDIO me NIPT: L01717030C

Vlera *2 190 637,79 ( dy milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH*

### **Janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. ERALD-G sh.p.k me Nipt K36306784K

Vlera: 2 201 578( *dy milion e dyqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë* ) Leke pa TVSH

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1.INSTITUTI DEKLIADA – ALB me Nipt K71606006A

Vlera: 2 190 511,15 ( *dy million e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje pesëmbëdhjetë* ) Leke pa TVSH

2.STUDIO SERVICES “K-SA” Me NIPT: L71305518R

Vlera: 2 190 511,23 ( *dy million e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje njëzet e tre* ) Leke pa TVSH

3. NOVATECH STUDIO me NIPT: L01717030C

Vlera 2 190 637,79 ( *dy milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

#### **INSTITUTI DEKLIADA – ALB:**

Në dokumentet e tenderit për Kapaciteti ekonomik dhe financiar është vendosur kriteri:

2.Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit ushtrimor 2018, 2019, 2020 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave dhe raportin e auditimit sipas kerkesave te ligjit Nr.10091 date 05.03.2009.

Nga verifikimi I bilanceve të paraqitura nga Operatori ekonomik rezulton se ka detyrimin ligjor për të kryer raportin e auditimit sipas kerkesave të ligjit Nr.10091 date 05.03.2009.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur raportin e auditimit, sa më sipër ky kriter nuk plotësohet.

#### **STUDIO SERVICES “K-SA”:**

Në kriteret e përgjithshme përcaktohet qartë se kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës.

Operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat për Kriteret e Përgjithshme të datës 22.04.2021, pra jo në datën e hapjes së ofertave që është 26.04.2021.

Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar,

Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës;

Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike,

Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit

Të gjitha deklaratat e mësipërme mbajnë datën 22.04.2021.

Për kapacitetin teknik është vendosur kriteri i mëposhtëm: Në lidhje me përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit sa 40% të vlerës së përlogaritur të fondit limit. Nga verifikimi I dokumentacionit rezulton se Operatori ekonomik ka paraqitur Kontratën me Nr.1128 date 05.06.2019 e cila rezulton se është realizuar nga bashkimi i Operatorëve STUDIO SERVICE KSA, në kontratë dhe në formularin e vlerësimit nuk është ndarë në përqindje shërbimi që ka marrë përsipër secili nga operatorët, rrjedhimisht nuk mund të përlogaritet vlera e kontratës që ka realizuar Operatori ekonomik STUDIO SERVICE KSA.

Është paraqitur Kontrata Nr.1929 datë 13.09.2019 edhe formuari i vlerësimit për këtë kontratë, Shërbimi sipas kontratës është realizuar nga bashkimi i operatorëve, Në formularin e vlerësimit dhe në kontratë nuk është ndarë në përqindje shërbimi që kanë marrë përsipër secili nga operatorët, rrjedhimisht nuk mund të përlogaritet vlera e kontratës që ka realizuar Operatori ekonomik STUDIO SERVICE KSA.

Sa më sipër kontratat nuk merren parasysh nga Autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për shërbime të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit sa 40% të vlerës së përlogaritur të fondit limit pasi kontrata e paraqitura arrijnë në vlerën 868 385,19 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë presje nëntëmbëdhjetë lekë PA TVSH.

Ofertuesi ekonomik duhet të paraqesë një listë të stafit kryesor (Drejtues Teknik në Liçencë të shoqërisë) të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë secilin prej tyre, diplomat, kontratat individuale të punës dhe Liçencën sipas legjislacionit në fuqi si vijon:

-Drejtuesi i Ekipit (inxhinier ndertimi) duhet të jetë pjesë e stafit teknik si drejtues teknik të shoqërisë dhe të figurojë në listpagesë i punësuar me kohë të plotë për periudhën e kërkuar Mars 2021 e në vazhdim,

Për të provuar pikën e mësipërme duhet të paraqitet, Kontrata e vlefshme për periudhën e realizimit të shërbimit, Diploma, Liçenca.

1 (një) Inxhinier ndërtimi ose Hidroteknik (Drejtuesi Ekipit).

1 (nje) inxhinier gjeodet/markshajder.

1 (nje) inxhinier elektrik.

Për drejtuesit teknik të mësipërm, pika 2.3.3, pjesë e stafit të cilët duhet detyrimisht të jenë si drejtues teknik të shoqërisë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë (ku të figurojnë të punësuar me kohë të plotë) për periudhën e kërkuar Mars 2021 e në vazhdim, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohë të plotë) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të kontratës për këtë objekt.

Nga verifikimi I Listepagesave rezulton se drejtuesit teknik të mësipërm nuk figurojnë të regjistruar me kohë të plotë.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për punësimin minimal prej 9 punonjësish për periudhën Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Çertifikatat ISO të paraqitura nga operatori ekonomik nuk i janë nënshtruar mbikqyrjes periodike vjetore.

## **NOVATECH STUDIO:**

Në dokumentet e tenderit është kërkuar në kriteret e veçanta:

Ofertuesi duhet të ketë pjese të stafit

- Ekspert për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedior.

Për këta OE të paraqesë:

- Diplomën

- Certifikat për ushtrim profesioni.

- Kontrata e punës dhe të figurojë në Formularët E-Sig 025/a.1 për periudhën– Shkurt 2021 e në vazhdim,e kërkuar më sipër.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për Ekspert për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedior.

Operatori ekonomik Novatech nuk ka paraqitur listëpagesat e shoqërisë E-Sig 025/a.

Ne kriteret e veçanta të kualifikimit është vendosur kriteri:

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

- 1 (një) punonjës si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se është paraqitur certifikatë me Nr.AQS/T/S39972020 si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë per Z. Kostandin Nova, data e lëshimit të certifikatës është 01.06.2020. rrjedhimisht nuk ka ekperiencën prej tre vitesh të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Eshtë paraqitur certifikatë me Nr.AQS/T/S67082020 si " Përgjegjës për dëmet në mjedis per Znj. Antonela Bazhdari, data e lëshimit të certifikatës është 16.10.2020 rrjedhimisht nuk ka ekperiencën prej tre vitesh të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga **ERALD-G** sh.p.k me NIPT K36306784K , me një vlerë të përgjithshme prej 2 201 578( *dy milion e dyqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë* ) *Leke pa TVSH* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni në *Bashkinë Bulqizë pranë zyrës juridike* për sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e këtij publikimi por ne cdo rast subjekti është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës ne zbatim të nenit 21 të Vkm 914, datë 29.12.2014 " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Ankesa: NUK KA

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **05/05/2021**

Data e publikimit të këtij njoftimi: **17/05/2021**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**  
**ENKELEDA LLESHI**